



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Emri i Biznesit:** “ISP BROADCAST” SH.P.K.

**Numri i biznesit:** 810011643

**Pronar:** Qëndrim KRYEZIU

**OSHMA:** “ISP AKSION”

**Adresa:** Rr/24 Maji, nr. 46-1, Prishtinë



## VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale “ISP Aksion” për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtësore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 8 mars 2021, kandidati “ISP Aksion”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes me përmbajtje tematike.

### Arsyetim


4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “ISP Aksion”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.
5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “ISP Aksion” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit

konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.

6. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së “ISP Aksion”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati “ISP Aksion” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

### Vendim

8. Komisioni në takimin e tij të mbajtur me datën 16 mars 2012, merr vendim që kandidatit “ISP Aksion”, me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



16.03.2021

datë